

ORGANET KOMPETENTE PËR REGJISTRIM TË PRONËS

Bazuar në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, organe kompetente për regjistrimin e të drejtave pronësore janë Zyrrat Kadastrale Komunale, ndërsa Agjencia Kadastrale e Kosovës është organ i nivelit qendror i shkallës së dytë, në cilësinë e organit për ankimim.

LLOJET E TË DREJTAVE PRONËSORE PËR REGJISTRIM

Procedurat për aplikim dhe regjistrim të të drejtave pronësore dallojnë varësisht të drejtës që regjistrohet, e ato janë si vijojnë:

- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME AKTVENDIM TRASHËGIMIE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË DHURIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË KËMBIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE ,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM GJYQSORË,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM NGA ORGANET TJERA KOMPETENTE,
- REGJISTRIM I PRONËSISË ME KREDITIM APO HIPOTEKË,
- BARTJE E PRONËSISË ME KONTRATË PËR NDËRTIM/KOMPENSIM,
- BARTJE E PRONËSISË NË BAZË TË PRANIMIT,
- REGJISTRIM I KONTRATËS ME MBAJTJE TË PËRHERSHME.

PRONËSIA ËSHTË E DREJTA E TËRËSISHME NË NJË SEND

Pronari mund të disponojë pronën e tij sipas dëshirës së tij, nëse kjo nuk kundërshtohet nga një palë e tretë ose nga ligji.

Për bartjen e të drejtës mbi paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme e ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Vetëm atëherë mund ta vërtetohet pronësia me anë të certifikatës së pronësisë.

Bazuar në këtë që u tha më sipër llojet e bartjes së të drejtës së pronësisë që regjistrohen në SIKTK janë:

- BLERJA,
- TRASHËGIMIA,
- DHURIMI,
- KËMBIMI,
- NDARJA FIZIKE,
- SHPRONËSIMI,
- VENDIM GJYQËSOR,
- VENDIM NGA ORGANET KOMPETENTE,
- KREDITIM/HIPOTEKË,
- NDËRTIM/KOMPENSIM,
- NË BAZË TË PRANIMIT DHE
- MBI MBAJTJEN E PËRJETSHME.

Agjencia Kadastrale e Kosovës
Rr: "Arbnor dhe Astrit Dehari" Nr. 25
10000
Pristinë
Republika e Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Katastarska Agencija Kosova
Kosovo Cadastral Agency

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË KADASTËR




REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË KËMBIMI



PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËSISË ME KONTRATË KËMBIMI

Kontrata e këmbimit është akt juridik që lidhet ndërmjet pronarëve të dy ose më shumë pronave të paluajtshme pasi që të njejtit kanë arritur marrëveshje për këmbimin e tyre.



Është e rëndësishme të theksohet që ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, e njohin të drejtën e pronësisë vetëm pas regjistrimit të saj në regjistër. Pra pronari i ri të drejtën e tij/saj mbi pronën e paluajtshme mund ta gëzojë vetëm pas regjistrimit të saj në emrin e tij / saj në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (RDPP).

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË KËMBIMIT

Lidhja e kontratës së këmbimit mund të bëhet tek noteri apo në gjykatë, sipas kompetencës territoriale të njërës nga pronat që janë objekt këmbimi. Palët e interesuara për të këmbyer prona duhet që para noterit apo në gjykatë të prezantojnë dokumentet e më poshtme:



- DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT TË PRONARËVE QË KËMBEJNË PRONAT OSE CERTIFIKATËN E BIZNESIT PËR PERSONA JURIDIK (KOPJE),
- CERTIFIKATËN E PRONËSISË JO MË E VJETËR SE GJASHTË MUAJ DHE
- LIDHJA E KONTRATËS SË DHURIMIT TEK NOTERI APO NË GJYKATË

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM NË ZYRËN KADASTRALE KOMUNALE

Pas marrjes së aktvendimit tek noteri apo në gjykatë, me qëllim të ekzekutimit të tij në kadastrë, pala duhet të kompletojë dokumentacionin si më poshtë:

- KËRKESA E PALËS,
- NJË KOPJE TË KONTRATËS SË KËMBIMIT TË NOTERIZUAR,
- DOKUMENT I IDENTIFIKIMIT PËR PRONARËT QË KËMBEJNË PRONAT OSE
- CERTIFIKATËN E BIZNESIT (KOPJE),
- CERTIFIKATËN E PRONËSISË (KOPJE), KOPJEN E PLANIT (KOPJE),
- DËSHMINË E PAGESËS SË TARIFËS PËR REGJISTRIM DHE
- DOKUMENTE TJERA SHITESË (NËSE KËRKOHET NGA ZKK, SI P.SH. TATIMI NË PRONË, ETJ).

